

# **Statuti dhe Akti Themelimit**

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
KLAU\_MAT ,sh.p.k

## **Neni 1**

### **Forma e Shoqërisë**

-Sot, më 22/10/2023, unë themeluesi Kristina Alushi , kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin KLAU\_MAT, sh.p.k.

- Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Akti I themelimit dhe Statuti jane në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo çështje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

-Themeluesit e shoqërisë janë:

1.KRISTINA ALUSHI ,shtetas shqiptar, i datëlindjes 26/07/1993 lindur në Livadhja, Greqi , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numur personal ID J35726078K, dhe me numur letërnjoftimi 032221433.

## **NENI 2**

### **Qendra e Shoqërisë**

Rruga “Besim Mema , Ndertesa 75 , Njësia Administrative Nr.10. Tirane.  
Cel; 0693424744, e mail alushi.kristina@yahoo.com

## **Neni 3**

### **Kohëzgjateja e Veprimtarisë Ekonomike**

-Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

## **Neni 4**

### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

-Shërbime në fushën e ndërtimit. Tregëti të lëndve të para të ndërtimit . Tregëti të mallrave dhe makinerive.Import-Eksport për tregtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë. Tregtim artikuj industrial,.Tregtim automjesh të cdo lloji.Transport mallrash te të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit .

## **Neni 5**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë Ortak, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asambles së ortakeve.

## **Neni 11**

### **Kompetencat e ortakeve**

Për mënyrën e drejtimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, ortakut shprehet me vendime për gjithshka që është në kompetencat e tyre të përshkruara si më poshtë:

Kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në statut.

Kanë të drejtë të miratojnë bilancin e shoqërisë dhe të bëjnë ndarjen e fitimit.

Ata emerojnë administratorët, zëvendësit, ekspertët dhe revizorët kontabel.

Ata aprovojnë çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencat e tyre

Miratojnë zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit

Përcaktojnë shpërblimin për administratorin, ekspertët, revizorët kontabel.

Bëjnë transferimin e kuotave të të tretet

Bëjnë lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.

Realizojnë blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajshme të shoqërisë.

Kanë të drejtë të bëjnë modifikimin e kontratës së shoqërisë, etj.

## **Neni 12**

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është ,shtetasja Shqiptare, Kristina Alushi e datëlindjes 26/07/1993 lindur në, Livadhja Greqi , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e Kartes ID me numur personal J35726078K me numer leternjoftimi 032221433.

Afati i mandatit është 5 (pese) vjet.

## **Neni 14**

Administratori mund të emerojë një ose më shumë administrator të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të vecanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

**Neni 20**  
**Bilanci dhe fitimet**

Veprimtaria ekonomike do të mbyllet në 31 dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakeve të shoqërisë.

**Neni 21**

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortakët vendosin brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtezakonshme të shoqërisë.

**Neni 22**

**Shpërndarja dhe likuidimi I shoqërisë**

Në rast se shoqëria shpërndahet për cdo lloj arsye asambleja e ortakeve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron nje ose me tëper likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme për cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

**Neni 23**

**Librat e shoqërisë**

Po keshtu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve te administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mësiperm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e cdo faqe duhet të jetë e vulosur.

**Neni 24**

**Dispozita të përgjithëshme**

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9901,datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” ,Ligjit 9723,datë 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,Statutit dhe regullores se brendshme të shoqërisë. Cdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë sic është nxjerr ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

**Kristina**

**Alushi**

Digitally signed by Kristina

Alushi

Tiranë,më 22/10/2023

Date: 2023.10.27 16:53:19

+02'00'

**Ortak i Vetëm**

**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**KLAU \_ MAT , sh.p.k**

**KRISTINA ALUSHI**

